



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nr. 495 Prot.

Patos, më 19/02/2024

MIRATOHET
KRYETARI
Faton Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 14, datë 19/02/2024

PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË SË
QYTETARIT Z. BARDHUL ALIAJ

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” pika 2, gërma “a” dhe VKM-së nr. 459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionin e qirasë ose uzufuktit, mënyra e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim, si dhe VKB-së nr. 81 datë 18.12.2023 për miratimin e buxhetit i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratoj bonusin e qirasë për periudhën 1-vjeçare janar-dhjetor 2024 për qytetarin Bardhul Aliaj në vlerën 30,000 (tridhjetë mijë) lekë.
2. Ky rimbursim të bëhet me 2 (dy) këste pasi qytetarit mund t'i ndryshoj statusi social, dhe me vërtetimin pas 6-muajsh të rimbursohet pjesa e mbetur.

Anëtarët e Programit të Strehimit Social

1. Boreta Murati

2. Anisa Kripa

3. Fajola Dervishaj

4. Grisilda Bektashi

5. Edona Beqaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nr. 495 Prot.

Patos, më 19.02./2024

RELACION
PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË SË
QYTETARIT Z. BARDHUL ALIAJ

Të nderuar Këshilltar !

Në vijimësi të kërkesës të z. Bardhul Aliaj për të përfituar bonusin e qirasë si familje në nevojë theksojmë se:

Bardhul Aliaj banues në lagjen "Naftëtari" Patos, ka aplikuar si i pastrehë dhe figuron në listën e strehimit me numër rendor 111 (njëqind e njëmbëdhjetë). Familja e tij përbëhet nga tre persona dhe në përbërjen familjare ka bashkëshorten me aftësi të kufizuar, e verbër grupi dytë.

Të ardhurat e familjes janë në total 30,584 (tridhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë sipas K.M.P.V. Sipas kontratës së qirasë me nr. repertori 615, nr. koleksioni 201, datë 01.03.2022 familja e z. Bardhul Aliaj jeton në këtë banesë, me numër pasurie 7/81+2-22, zona kadastrale 2890, volumi 8, faqe 120, me sipërfaqe 55 m² (pesëdhjetë e pesë) në lagjen "Naftëtari" kundrejt vlerës 5,000 (pesë mijë) lekë në muaj, me një afat kohor kontrate 5 (pesë) vjeçare.

Në V.K.B nr. 81, datë 18.12.2023 për miratimin e buxhetit 2024, zëri rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje. Për familjet që si pjesë taksuese sipas normave të strehimit duhet të strehohen në banesën 1+1, vlera në tregun e lirë e tetstuar është 5,000 (pesë mijë) lekë dhe rimbursim 50% e vlerës është e barazvlefshëme me 2,500 (dy mijë e pesqind) lekë në muaj. Për periudhën një vjeçare janar-dhjetor 2024 në vlerë totale 30,000 (tridhjetë mijë) lekë. Kjo vlerë të rimbursohet me dy këste, pasi qytetarit mund t'i ndryshoj statusi social.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtorja e financës.

Anëtarët e Programit të Strehimit Social

1. Boreta Murati

2. Anisa Kripa

3. Fabjola Dervishaj

4. Grisilda Bektashi

5. Edona Beqaj

6. Shkëlqim Beqiraj

KRYETARI
Fation Duro